



2023

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive.....	2
I. Mandati i Prokurorit të Shtetit.....	3
II. Përgjegjësitë e Prokurorit të Shtetit.....	4
III. Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit.....	5
IV. Vlerat	6
V. Zbatimi i Planit të Punës	7
VI. Objektivat e Prokurorit të Shtetit.....	8
<i>a. Rritja e efikasitetit në luftimin kundër korrupsionit, pastrimit të parave, krimeve ekonomike krimi të organizuar dhe terrorizmit.....</i>	<i>9</i>
<i>b. Trajtimi me prioritet i veprave penale kundër integritetit seksual dhe dhunës në familje.....</i>	<i>11</i>
<i>c. Menaxhimi efikas, mbikëqyrja dhe llogaridhënia e vazhdueshme e punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve.....</i>	<i>12</i>
<i>d. Ngritja e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar</i>	<i>13</i>
<i>e. Zvogëlimi i numrit të lëndëve penale, veçmas nga regjistri PPP</i>	<i>16</i>
<i>f. Aplikimi i procedurave alternative në zgjedhjen e rasteve penale.....</i>	<i>18</i>
<i>g. Rritja e transparencës dhe besimit të publikut</i>	<i>22</i>
<i>h. Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe me partnrët ndërkombëtar</i>	<i>24</i>

Përmbledhje ekzekutive

Prokurorit i Shtetit me qëllim të ushtrimit të mandatit ligjor, në zbatim të kompetencave dhe përgjegjësive ligjore dhe kushtetuese si dhe Planit strategjik të Sistemit Prokurorial, ka hartuar Planin vjetor të punës për vitin 2023.

Plani ka për qëllim funksionimin efikas, ngritjen, avancimin dhe profesionalizmin e punës së Prokurorit të Shtetit.

Plani i Punës për vitin 2023, përmban pjesën hyrëse në të cilën përshkruhet mandati, përgjegjësitë dhe struktura organizative e Prokurorit të Shtetit, përfshirë vizionin dhe misionin e tij.

Pjesa e dytë e Planit ka përcaktuar objektivat e Prokurorit të Shtetit për vitin 2023 me të cilat synohet avancimi i sistemit të punës, mbikëqyrjes dhe llogaridhënies në institucionin e Prokurorit të Shtetit.

Në pjesën e tretë të planit, objektivat janë konkretizuar në formë tabelare përmes aktiviteteve, treguesve, bartësve të aktiviteteve dhe afateve kohore për realizimin e objektivave.

Zbatimi i këtij plani mundëson përmbushjen e kompetencave dhe përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore të Prokurorit të Shtetit.

Me rastin e hartimit të Planit të Punës janë marrë parasysh sfidat dhe rreziqet që mund të paraqiten si pasojë e ndryshimeve ligjore, resurseve buxhetore dhe kapaciteteve njerëzore.

I. Mandati i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit është institucion kushtetues, i pavarur, kompetent dhe përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale.

Funksionet e veta Prokurori i Shtetit i ushtron në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, duke siguruar që të gjithë pa dallim të kenë trajtim të barabartë para ligjit, pavarësisht gjinisë, racës, prejardhjes kombëtare apo sociale, shoqatave apo lidhjeve politike, besimeve fetare, gjendjes apo të metave shëndetësore, apo edhe pozitës shoqërore.

Prokurori i Shtetit i kryen përgjegjësitë dhe detyrat e veta, duke u bazuar në standardet më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare duke respektuar plotësisht të drejtave dhe lirit themelore të njeriut, si dhe duke i kryer në mënyre profesionale dhe objektive të gjitha veprimet hetimore në përputhje me procedurën penale.

II. Përgjegjësitë e Prokurorit të Shtetit

Përgjegjësitë kryesore të Prokurorit të Shtetit përfshijnë:

- ❖ Ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat të trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
- ❖ Zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
- ❖ Sjellje të ndershme dhe profesionale në jetën personale dhe profesionale, duke u bazuar në ligjet e zbatueshme dhe Kodin e Etikës profesionale;
- ❖ Ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;
- ❖ Mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar;
- ❖ Ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit, si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;
- ❖ Marrjen e vendimeve për iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;
- ❖ Ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;
- ❖ Ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;
- ❖ Bashkëpunimin me Policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera dhe
- ❖ Ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

III. Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit ka strukturën organizative si në vijim:

- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, si instanca më e lartë e Prokurorisë së Shtetit, me kompetenca në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përveç mbikëqyrjes dhe monitorimit të punës të prokuroreve të shtetit, ndërmarrë edhe veprime juridike për të mbrojtur ligjshmërinë në të gjitha çështjet penale, civile, administrative dhe ekonomike.
- Prokuroria e Apelit, e cila është shkallë e dytë dhe ka kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, me autorizim ligjor për të vepruar dhe përfaqësuar lëndet në Gjykatën e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e cila vendos për mjetet e rregullta juridike.

Prokuroria e Apelit ka këto departamente:

- ✓ Departamenti e Përgjithshëm;
 - ✓ Departamenti për të Mitur dhe
 - ✓ Departamentin për Krime të Rënda.
- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, si organ prokurorial i specializuar, e cila ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës, me kompetenca dhe përgjegjësi për të hetuar dhe ndjekur krimet që janë në kompetencë të veçantë dhe plotësuese të PRSK-së.

Prokuroria Speciale ka këto departamente:

- ✓ Departamenti e Krimeve të Luftës;
 - ✓ Departamentin e Terrorizmit;
 - ✓ Departamenti për Krim të Organizuar dhe Krime të Tjera dhe
 - ✓ Departamenti për Korrupsion dhe Krime Financiare.
- Prokuroritë Themelore, të shtrira në territorin e shtatë (7) rajoneve të Kosovës, me kompetencë për të zhvilluar hetime dhe ndjekje penale, për të ngritur aktakuza dhe për të përfaqësuar në Gjykatat Themelore si gjykata të shkallës së parë.

Prokurorit Themelore kanë këto departamente:

- ✓ Departamentin e Përgjithshëm;
- ✓ Departamenti për të Mitur dhe
- ✓ Departamentin për Krime të Rënda.

IV. Vlerat

Prokurori i shtetit si institucion i pavarur karakterizohet nga vlerat si në vijim:

Profesionalizmi, llogaridhënia pavarësia në punë dhe
transparenca

Integriteti dhe etika e lartë

Paanshmëria, përkushtimi dhe objektiviteti në trajtimin e
rasteve penale bazuar në standarde më të larta vendnore dhe
ndërkombëtare

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në punë dhe përdorimi
racional i resurseve

Promovimi i bashkëpunimit me akterët e tjerë të sundimit të
ligjit

V. Zbatimi i planit të punës

Plani i Punës bazohet në mandatin ligjor dhe në vizionin e Kryeprokurorit të Shtetit për udhëheqjen e këtij institucioni. Realizimi i këtij plani do të bëhet përmes zbatimit të objektivave, të cilat janë të matshme dhe të arritshme, dhe do të realizohen me aktivitete dhe masa konkrete sipas afateve të caktuara.

Plani parasheh vazhdimin e disa aktiviteteve dhe masave, të cilat kanë filluar në vitet paraprak dhe zbatimi i tyre do të vazhdojë edhe këtë vit.

Në përcaktimin e objektivave të këtij plani, Prokurori i Shtetit, krahas mandatit, ka marrë për bazë edhe prioritetet shtetërore, që dalin nga aderimi në mekanizma ndërkombëtarë, siç janë Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociimi (MSA) apo iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare për luftimin e krimit transnacional.

Prokurori i Shtetit ka përcaktuar disa vepra penale, të cilat do të trajtohen me prioritet gjatë punës së tij në vitin 2023. Trajtimi i këtyre veprave penale ndërlidhet me proceset e fuqizimit të sundimit të ligjit, dhe krijimin e ambientit të sigurt në investimet e huaja dhe avancimin e proceseve të integritetit evropian.

Format e kriminalitetit me prioritet të lartë do të jenë: korrupsioni, krimet ekonomike, krimi kibernetik, krimi i organizuar, krimet e luftës krimet në baza gjinore, dhuna në familje, integriteti seksual, shpëlarja e parave, terrorizmi etj.

Po ashtu, në fokus do të jenë shtimi dhe trajtimi i rasteve të shenjëstruara nga mekanizmi tani më i krijuar nga Kryeprokurori i Shtetit disa vite më parë.

Me qëllim të luftimit efikas të këtyre grupeve të veprave penale, Prokurori i Shtetit synon fuqizimin e strukturave ekzistuese dhe krijimin e mekanizmave të tjerë të nevojshëm. Krahas këtyre veprimeve, Prokurori i Shtetit do të zbatojë edhe prioritete që dalin nga dokumentet strategjike kombëtare dhe dokumentet përkatëse të institucionit të Prokurorit të Shtetit.

VI. Objektivat e Prokurorit të Shtetit

a. Rritja e efikasitetit në luftimin kundër korrupsionit, pastrimit të parave, krimeve ekonomike, krimit të organizuar dhe terrorizmit

b. Trajtimi me prioritet i veprave penale kundër intergritetit seksual dhe dhunës në familje

c. Ngritja e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar

d. Menaxhimi efikas, mbikëqyrja dhe llogaridhënia e vazhdueshme e punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve

e. Zvogëlimi i numrit të lendeve penale, veçanërisht nga regjistri PPP

f. Aplikimi i procedurave alternative në zgjedhjen e rasteve penale

g. Rritja e transparencës dhe besimit të publikut

h. Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe me partnerët ndërkombëtar

a. Rritja e efikasitetit në luftimin kundër korrupsionit, pastrimit të parave, krimeve ekonomike krimin të organizuar dhe terrorizmit

Prokurori i Shtetit mbetet i përkushtuar që ndër prioritet e veçanta dhe të vazhdueshme për vitin 2023 do të jetë hetimi dhe ndjekja e kryerësve të veprave penale që lidhen me detyrën zyrtare, konkretisht, korrupsionin, pastrimin e parave, krimeve ekonomike , krimin të organizuar dhe terrorizmit.

Prokurori i Shtetit do të ndërmerr veprime konkrete për ta avancuar dhe fuqizuar Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Prokuroritë Themelore me theks të veçantë Prokurorinë Themelore të Prishtinës, posaçërisht Njësitin për Luftimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në atë mënyrë që të gjitha lëndët e kësaj natyre të trajtohen me prioritet të lartë, profesionalizëm dhe efikasitet.

Krimi i organizuar dhe terrorizmi si një prej veprave penale që cenojnë rëndë rendin dhe ligjin në vendin tonë e posaçërisht sigurinë dhe pasurinë e qytetarëve do të jetë prioriteti ynë që në mënyrë të vazhdueshme të nxjerrim para drejtësisë kryesit e këtyre veprave penale.

Trajtimi me prioritet i këtyre veprave penale është kërkesë e vazhdueshme e organeve të sistemit prokurorial dhe mekanizmave ndërkombëtar. Andaj, për të rritur efikasitetin në trajtimin e këtyre rasteve, në vazhdimësi jemi duke punuar që prokurorët të profilizohen të caktohen koordinator për disa kategori të veprave penale, të trajnohen prokurorët në vazhdimësi për të ngritur profesionalizmin në hetimin e këtyre veprave specifike.

Fuqizojë PSRK-në dhe prokuroritë themelore në trajtimin e korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimeve ekonomike

Trajtojë me prioritet rastet kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave, trafikimit të qenjeve njerëzore, terrorizimit, drogave, armëve dhe veprave penale kibernetike

Trajtoj rastet kundër krimeve të luftës

Fuqizojë punën e Njësitit për Korrupsion dhe Krim Ekonomik në Prokurorinë Themelore të Prishtinës dhe të kërkoj angazhim edhe në prokuroritë tjera themelore.

Profilizimi

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Trajnimet specifike

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Vizitat studimore

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Kolegjiumet me Kryeprokurorët dhe prokurorët

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Bashkërendimi i aktiviteteve me akterët e sundimit të ligjit

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Bashkëpunimi me partnerët e brendshme dhe të jashtëm me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Mbikëqyrja e punëve të Prokurorive

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

b.) Trajtimi me prioritet i veprave penale kundër integritetit seksual dhe dhunës në familje

Prokurori i Shtetit duke pasur parasysh situatën e fundit ku janë rritur në mënyrë drastike veprat penale kundër integritetit seksual dhe dhunës në familje, gjatë vitit 2023 objektivë të veçantë do të ketë trajtimin me prioritet të këtyre veprave, posaçërisht veprat penale kundër integritetit seksual ngase në këtë kategori të veprave penale kemi përfshirje të moshave të mitura në cilësinë e viktimave që kërkojnë përkushtim dhe trajtim të veçantë.


Në këtë drejtim, Kryeprokurori i Shtetit, ka nxjerrë vendim ku ka caktuar Koordinatorin në nivel të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Prokurorive Themelore me qëllim të unifikimit, trajtimit sa më efikas dhe profesional të këtyre veprave nga ky kapitull.

Koordinatori i caktuar në bashkëpunim me koordinatorët e tjerë, kanë filluar bashkëpunimin me akterët e tjerë të drejtësisë, si policinë, mbrojtësit e viktimave, qendrat për punë sociale, psikologët, përfaqësuesit e institucioneve edukativo-arsimore me qëllim të sensibilizimit dhe koordinimit ndërmjet këtyre institucioneve për të luftuar me sukses këtë kategori të veprave penale.

Sa i përket veprave penale të dhunës në familje, koordinatorët e caktuar nëpër prokuroritë e Kosovës dhe Koordinatorja në nivel të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, janë duke punuar në vazhdimësi për ta avancuar trajtimin sa më profesional dhe efikas të kësaj kategorie.

Gjatë vitit 2023, objektivë e Prokurorit të Shtetit do të jetë zbulimi dhe ngritja në mënyrë sa më profesionale e akteve akuzuese për këto kategori të veprave penale, unifikimi i praktikave në nivel të të gjitha prokurorive, bashkërendimi me institucionet tjera të zbatimit të ligjit, si Policia, qendra për punë sociale, institucionet edukative-arsimore, etj., me qëllim të parandalimit dhe nxjerrjes para drejtësisë kryerësit e këtyre veprave.

Gjithashtu, koordinatorët do të bëjnë përpjekje për mbajtjen e ligjëratave vetëdijesuese në institucionet të ndryshme edukativo-arsimore.



Raportimet e rregullta

- Përgjegjës: Koordinatorët në ZKPSH, PTH dhe ZMNV
- Janar - Dhjetor

Vlerësimi i hedhjeve të kallëzimeve penale dhe pushimi i hetimeve

- Përgjegjës: Koordinatorët në ZKPSH, PTH dhe ZMNV
- Janar - Dhjetor

Udhëzimet e detyrueshme të Kryeprokurorit të Shtetit

- Përgjegjës: ZKPSH, koordinatorët, PTH dhe ZMNV
- Janar - Dhjetor

Takimet e koordinatorëve me aketrët e tjerë

Përgjegjës: Koordinatorët e ZKPSH dhe PTH

- Janar - Dhjetor

Monitorimi i punës së prokurorëve përgjegjës nga koordinatorët e ZKPSH-së

- Përgjegjës: ZKPSH dhe PTH
- Janar - Dhjetor

c.) Menaxhimi efikas, mbikëqyrja dhe llogaridhënia e vazhdueshme e punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve

Llogaridhënia mbetet një prej elementeve më të rëndësishme të punës së Prokurorit të Shtetit. Institucioni i Prokurorit të Shtetit mbetet i përkushtuar për të avancuar sistemin e mbikëqyrjes së punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve në forcimin e llogaridhënies për të ngritur nivelin e cilësisë, profesionalizmit, sjelljes dhe efikasitetit me rastin menaxhimit dhe trajtimit të rasteve penale.

Veprimet e Kryeprokurorit të Shtetit për ta realizuar këtë objektivë do të jenë; zhvillimi i vizitave, caktimi i prokurorëve mbikëqyrës nga ZKPSH për prokuroritë përkatëse, mbajtja e kolegjiave me kryeprokurorët dhe takimeve të rregullta nëpër të gjitha nivelet e prokurorive, tryeza për diskutim të çështjeve profesionale, mbikëqyrja për zbatimin e Kodit të Etikës dhe shkeljeve profesionale, si dhe zhvillimi i anketave për vlerësimin objektiv të punës së kryeprokurorëve të prokurorive.

Në drejtim të llogaridhënies sistematike, Kryeprokurori i shtetit dhe kryeprokurorët do të kërkojnë në baza të rregullta raporte me shkrim për të parë ecurinë e trajtimit të rasteve penale, praktikat e përdorura si dhe rezultatet e treguara.

Kryeprokurori i Shtetit me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe profesionalizmit të punës së prokurorëve do të vazhdojë të nxjerrë udhëzime të detyrueshme që do të ndihmojnë në zbatimin sa më unik dhe të saktë të dispozitave të caktuara ligjore.

Kryeprokurori i Shtetit do të vazhdojë të mbikëqyrë zbatimin e këtyre udhëzimeve dhe do të ndërmarrë veprime atëherë kur paraqitet nevoja me qëllim të rritjes së efikasitetit për transferim të përkohshëm të prokurorëve në prokurori të caktuara.

Në drejtim të kësaj, Kodi i Etikës dhe sjelljes profesionale për prokurorë i miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, do të jetë objektivë kryesore për të mbikëqyrur sjelljet etike dhe profesionale të kryeprokurorëve dhe prokurorëve të shtetit.

Respektimi i Kodit të Etikës është demonstrim i nivelit më të lartë të profesionalizmit duke u bazuar në vlerat dhe parimet si pavarësia, paanshmëria, integriteti, llogaridhënia, transparenca dhe profesionalizmi i prokurorit të shtetit.

Menaxhimi efikas dhe mbikqyrja e punës

Zbatimi i udhëzimeve të detyrueshme

Forcimi i llogaridhënies

Zbatimi i Kodit të Etikës

Takimet dhe raportimet e rregullta

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Raportet dhe ankesat për hedhjen të kallëzimeve penale dhe pushimi i hetimeve

- Përgjegjës: Prokuroria e Apelit, ZKPSH, kryeprokurorët
- Janar - Dhjetor

Udhëzimet e detyrueshme të Kryeprokurorit të Shtetit

- Përgjegjës: ZKPSH, Prokuroria e Apelit, PSRK dhe PTH-të
- Janar - Dhjetor

Kolegjiomet me Kryeprokurorët dhe prokurorë

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Monitorimi i punës së Prokurorive nga prokurorët e ZKPSH dhe Koordinatorët e ZKPSH-së

- Përgjegjës: ZKPSH, PTH
- Janar - Dhjetor

Mbikëqyrja e zbatimit të Kodit të Etikës nga autoriteti kompetent

- Përgjegjës: Kryeprokurori i Shtetit dhe kryeprokurorët e prokurorive
- Janar - Dhjetor

b. Ngritja e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të pasurisë së fituar me vepër penale

Sa i përket kësaj objektive në sekuestrimin e aseteve të fituara përmes veprave penale, Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2023 do të vazhdoj ta ketë synim dhe të punoj në drejtim të rritjes së cilësisë së akteve të prokurorit, ku propozohet sekuestrimi i aseteve të fituara me vepër penale, në mënyrë që rrjedhimisht të ketë rezultate edhe në konfiskimin përfundimtar nga ana e gjykatave.


Gjatë vitit 2023, pas ndryshimeve të reja ligjore do të kërkohet kontroll sistematik i rasteve të krimeve ekonomike, korrupsionit, shpëlarjes së parave, terrorizmit dhe krimit të organizuar të cilat rezultojnë me sekuestrim dhe konfiskim.

Rritja e shkallës së sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të aseteve të fituara me vepër penale do të jetë objektivë themelore për faktin se pritet të ketë ndryshime të ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe Prokurorinë Speciale, ku më këto ligje synohet t'iu jepet përgjegjësi dhe kompetenca shtesë këtyre institucioneve.

Për më tepër, Kryeprokurori i Shtetit do të vazhdoj të kërkojë aplikimin e shtuar të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale.

Prokurori i Shtetit do të ketë bashkëpunim të afërt edhe me institucionet e tjera ligjzbatuese për bashkërendimin e aktiviteteve për te pasur rezultate në sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të fituara kundërligjshëm.

Kujdes i veçantë do t'i kushtohet sekuestrimit të pasurisë në rastet e veprave penale, në të cilat janë të përfshirë kryerës të profilit të lartë.



Monitorimet dhe raportimet e rregullta

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK , PTH dhe Koordinator i Nacional
- Janar - Dhjetor

Zbatimi i udhëzimeve

Përgjegjës: Prokuroria e Apelit, PSRK dhe PTH

- Janar - Dhjetor

Mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet kryeprokurorëve dhe prokurorëve të rastit

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Monitorimi i punës së prokurorive për zbatimin e ligjit për kompetencat e zgjeruara

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK, PTH dhe Koordinator i Nacional
- Janar - Dhjetor

Mbikëqyrja e veprimeve të prokuroreve për parashtrimin e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK, PTH dhe Koordinator i Nacional
- Janar - Dhjetor

Rritja e numrit të vendimeve për ngrirje dhe sekuestrim

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

c. Zvogëlimi i numrit të lëndëve penale, veçmas nga regjistri PPP

Prokurori i Shtetit përgjatë viteve të fundit ka ngritur nivelin e trajtimit të lëndëve penale, duke zvogëluar dukshëm numrin e lëndëve të trashëguara. Kjo tregohet përmes raporteve vjetore të punës ku paraqitet përqindja e lartë e rasteve të kryera, përfshirë këtu edhe vendimet fajësuese të gjykatave. Mirëpo, një problem i vazhdueshëm ka qenë dhe mbetet numri i lartë i lëndëve nga regjistri me kryes të panjohur (PPP), të bartura ndër vite.

Statistikisht ky numër po ndikon negativisht në pasqyrimin real të rezultateve të mira të punës së bërë nga Prokurori i Shtetit. Andaj, objektivë kyçe e Prokurorit të Shtetit në vazhdim do të jetë puna në zvogëlimin e këtyre lëndëve. Prokurori i Shtetit ka zvogëluar në masë të konsiderueshme lëndët e trashëguara nga ky regjistër, megjithatë ende mbetet një numër i konsiderueshëm i këtyre lëndëve, me theks të veçantë në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Gjatë vitit 2023, fokusi i Prokurorit të Shtetit do të jetë në zgjidhjen e lëndëve të mbetura në punë nga vitet paraprake, përmes angazhimit të burimeve njerëzore shtesë (bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjorë) si dhe nëse ka nevojë varësisht nga rezultatet edhe prokurorë përmes transferimeve të përkohshme.

Kryeprokurori i Shtetit do të kërkojë nga prokuroritë themelore dhe PSRK që të hartojnë planet specifike të veprimeve për qasje në zgjidhjen e lëndëve të trashëguara, në veçanti lëndëve me kryes të panjohur dhe atyre me raporte të veçanta.

Prokurori i shtetit do të vazhdojë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ngritjen proaktive të këtij bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe institucionet tjera relevante në rritjen e efikasitetit në zbulimin dhe hetimin e kryerësve të panjohur të veprave penale, si dhe parashtrimin e kallëzimeve penale me qëllim të arritjes së objektivave të parapara në këtë plan.

Vlerësimi i gjendjes me natyrën e këtyre veprave penale

Planifikimi i prokurorive në trajtimin e këtyre rasteve

Koordinimi në zgjidhjen unike të rasteve me PPP

Raportimi dhe monitorimi për zgjidhjen e këtyre rasteve

Përgatitja e raporteve, vlerësimi dhe analiza e gjendjes së lëndëve në secilën prokurori me kryes të panjohur(PPP)

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Koordinimi dhe unifikimi i praktikave për trajtimin e rasteve me kryes të panjohur(PPP).

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Trajtimi i rasteve me kryes të panjohur(PPP) në koordinim me Policin e Kosovës

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Mobilizimi i të gjitha resurseve të burimeve njerëzore në trajtimin e këtyre lendeve

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Mbyllja e të gjitha lëndëve që kanë arritur parashkrimin absolut

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Monitorimi në vazhdimësi i punës nga kryeprokuroret dhe Kryeprokurori i Shtetit

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

d. Aplikimi i procedurave alternative në zgjedhjen e rasteve penale

Prokurori i Shtetit gjithnjë ka pasur për objektivë aplikimin e procedurave alternative si procedurë e veçantë në zgjidhjen sa më të shpejtë dhe më efektive të rasteve penale.

Ndryshimet e reja ligjore kanë avancuar në aplikimin e proceduarve alternative, ngase kanë rritur gamën e veprave penale që mund të zgjidhen me ndërmjetësim dhe forma tjera të procedurës alternative.

Kryeprokurori i Shtetit në Planin e Punës edhe për këtë vit ka vendosur t'i kushtojë vëmendje më të shtuar aplikimit më efikas të metodave alternative në zgjidhjen e rasteve penale, duke u përqendruar në negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe ndërmjetësimin.

Përdorimi i këtyre metodave mundëson efikasitet dhe efektivitet të procedurës, qasje më të lehtë në drejtësi, ekonomizim të procedurës dhe reduktim të numrit të rasteve në gjyqësor.

Zgjedhja e rasteve në procedura alternative konsiderohet një mjet shumë i rëndësishëm të cilin prokurori mund ta përdorë, çdo herë kur të plotësohen kushtet e parapara me ligj, synimi ynë mbetet rritja e numrit të rasteve të referimit me procedura alternative.

Prokurori Shtetit duke e konsideruar si objektivë në vazhdim ka caktuar nëpër prokurori themelore zyrtarë të ngarkuar me ndërmjetësim, mirëpo synohet që të bëhet rekrutimi i zyrtarëve për ndërmjetësim dhe sa i përket aplikimit sa më adekuat të këtyre procedurave kërkohet fuqizimi i komunikimit mes prokurorisë dhe ndërmjetësuesve.

Rritja e zgjedhjes së rasteve me procedurë alternative do të ndikojë në ekonomizimin e kohës dhe shpenzimeve tjera në sistemin prokurorial, por mbi të gjitha palët do të marrin drejtësi me kohë dhe pa pasur nevojë për procese të stërzgjatura gjyqësore.

Aplikimi i procedurave alternative

Rekrutimi i stafit

Rritja e bashkëpunimit ndërmjet prokurorëve dhe ndërmjetësuesve për aplikimin e procedurave alternative

Raportimi dhe monitorimi i punës

Ngritja e numrit të rasteve në aplikimin e procedurave alternative

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Nevoja për rekrutimin e zyrtarëve për ndërmjetësim në Prokurorit Themelore

- Përgjegjës: KPK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Avancimi i komunikimit ndërmjet prokurorëve dhe ndërmjetësuesve

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Procedura alternative si tregues në vlerësimin e performances individuale të prokurorit

- Përgjegjës: Kryeprokurori i Shtetit dhe kryeprokurorët e prokurorive të PSRK-së dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Raportimi dhe monitorimi i rregulltë për zgjedhjen e rasteve me procedurë alternative

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

e. Rritja e transparencës dhe besimit të publikut

Avancimi i transparencës dhe informimi i publikut mbetet një përkushtim i vazhdueshëm me qëllim që publiku dhe opinioni i gjerë të mbahet i informuar lidhur me çështjet me interes të përgjithshëm nga fushëveprimtaria e Prokurorit të Shtetit.

Kjo synohet të bëhet përmes fuqizimit të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, si ngritja e profesionalizmit të zyrtarëve për komunikim publik nëpër prokurori dhe zbatimi i akteve nënligjore që rregullojnë fushën e komunikimit me publikun si indikacion i prekshëm për ngritjen e transparencës, përmes ofrimit të qasjes më të lehtë të qytetarëve, mediave dhe shoqërisë civile në informatat e këtij organi kushtetues, duke përfshirë edhe procesin e vendimmarrjes

Hartimi i politikave të reja të komunikimit është nevojë për ngritjen e transparencës, që nënkupton edhe ngritjen e besueshmërisë së publikut në institucionin e Prokurorit të Shtetit.

Ne do të vazhdojmë të avancojmë komunikimin e brendshëm dhe atë të jashtëm, ku do të angazhohemi që të kemi komunikim proaktiv me mediat dhe shoqërinë civile, si dhe koordinimin me institucionet e tjera të sistemi të drejtësisë të parapara për përmirësimin e komunikimit dhe rritjes së transparencës.

Në vitin 2023, Kryeprokurori i Shtetit synon që në pajtim me Rregulloren për shërbimin e komunikim publik në sistemin prokurorial dhe Strategjinë e komunikimit në sistemin prokurorial (2021-2023) të avancojë efikasitetin e mekanizmave të brendshëm për shpërndarjen e informacionit.

Natyrisht, Prokurori i Shtetit duhet të sigurohet që gjatë komunikimit me publikun të sigurojë balancimin në mes të ruajtjes së hetimeve për rastet që është duke i ndjekur penalisht dhe interesit të përgjithshëm për informim të publikut.

Publikimi i aktiviteteve të Prokurorit të Shtetit në të gjitha nivelet



Publikimi i aktiviteteve me kohë

- Përgjegjës: Zyrtarët për Komunikim Publik në ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor


Oganizimi i takimeve, tryezave dhe konferencave



Publikimi i broshurave dhe buletinave për informimin e publikut për punën e prokurorit të shtetit

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor


Ndryshimi dhe avancimi i uebportalit të Prokurorit të Shtetit



Paraqitja e prokurorëve dhe zyrtareve nëper media kur është e nevojshme


- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH
- Janar - Dhjetor

Raportimi dhe monitorimi i punës




Organizimi i takimeve, tryezave dhe i konferencave për media për rastet me interes të lartë për publikun

- Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK, PTH dhe Zyra për Komunikim Publik
- Janar - Dhjetor



Reagimi me kohë

- Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK, PTH dhe Zyra për Komunikim Publik
- Janar - Dhjetor



Monitorimi dhe zbatimi i Strategjisë për Komunikim me Publikun dhe trajnimit të prokurorëve

- Përgjegjës: ZKPSH, PSRK, PTH dhe Zyra për Komunikim për Publik
- Janar - Dhjetor

f. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe fuqizimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar

Prokurori i Shtetit synon që të avancojë bashkëpunimin me të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit në Kosovë me qëllim të realizimit të mandatit ligjor. Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare, si dhe përkrahja nga partnerët dhe donatorët është shtyllë e rëndësishme në fuqizimin e punës sonë profesionale dhe të pavarur.

Gjithashtu, Prokurori i Shtetit do të fuqizojë bashkëpunimin ndërkombëtar në aspektin e ndihmës juridike ndërkombëtare, pjesëmarrjes në konferenca, trajnime dhe forma tjera të organizuara nga forumet e ndryshme ndërkombëtare.

Prokurorit të Shtetit, synon që realizimin e këtij bashkëpunimi të bëjë përmes formave të shkëmbimit të ndërsjellë, vizitave studimore, nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit përvojave dhe informacioneve.

Gjatë viteve paraprake kemi zbatuar politikat e bashkëpunimit profesional dhe proaktiv me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, Prokurori i Shtetit ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe ka përfituar projekte të ndryshme në vazhden e bashkëpunimit ndërinstitucional, përmes të cilave kanë fuqizuar koordinimin ndërinstitucional në realizimin e mandatit kushtetues dhe ligjor, me fokus të veçantë në luftimin e dukurive të kundërligjshme .

Prokurori i Shtetit për realizimin sa me efikas të bashkëpunimit ndërkombëtar do të bashkërendojë veprimet me prokurorët e caktuar në prokuroritë e të gjitha niveleve, përfshirë edhe ZKPSH-në.

Bashkëpunimi me institucionet e zbatimit të ligjit

Koordinimin me institucionet e sundimit të ligjit për ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional

Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH

• Janar - Dhjetor

Koordinimi dhe bashkrendimi për Ndhmë Juridike Ndërkombëtare

Avancimi i bashkëpunimit me prokuroritë e vendeve tjera në interes të dyanshëm për luftimin e krimit

• Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH

• Janar - Dhjetor

Partnerët vendor dhe ndërkombëtarë

Koordinimi dhe bashkërendimi i brendshëm lidhur me Ndhmën Juridike Ndërkombëtare

• Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK, PTH dhe prokurorët e caktuar

• Janar - Dhjetor

Raportimi dhe monitorimi i punës

Bashkëpunimi me partnerët

• Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH

• Janar - Dhjetor

Koordinimi me donatorë në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit

• Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH

• Janar - Dhjetor

Raportimi dhe monitorimi i rregulltë për zgjedhjen e rasteve me Ndhmë Juridike Ndërkombëtare

• Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH

• Janar - Dhjetor

Prokurori i Shtetit gjatë realizimit të Planit të Punës në vitin 2023, ka paraparë edhe sfidat që mund të ndikojnë në zbatimin e këtij plani përmes aktiviteteve dhe veprimeve që do të ndërmerren në kuadër të ushtrimit të përgjegjësive dhe kompetencave kushtetuese dhe ligjore.

Disa nga sfidat që mund ta përcjellin Prokurorin e Shtetit përgjatë vitit 2023 mund të jenë disa;

- Ndryshimet ligjore në ligjet bazike;
- Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale;
- Buxheti i pamjaftueshëm;
- Lëvizjet e prokurorëve përmes transferimit dhe avancimit brenda sistemit;
- Numri i pamjaftueshëm i prokurorëve në disa prokurori themelore;
- Situata e krijuar me prokurorët nga komuniteti serb në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës.